



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15/09/23 Ref.: 1197/23

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ, Nr.20/12 qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë,(përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më 25 gusht 2023, mori:

V E N D I M

- I. **Aprovohet propozimi i Komisionit të Ankesave** të lidhur me ankesën e Kolegjit Dardania me Nr.Prot.696/23 dhe 893/23 kundër vendimit të KShC-së Nr.Ref:533/23, datë 19.04.2023.
- II. **Ndryshohet** vendimit Ref.533/23 i datës 19.04.2023, largohet pika II e dispozitiveit të këtij vendimi.
- III. **Obligohet** Agjencia e Kosovës për Akreditim, që menjëherë të tërheq raportin me rekomandime të Ekipit të Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertëve ndërkombëtarë) nga ueb.faqja e saj.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit mbetet në fuqi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Dardania në afatin ligjor ka parashtruar ankesë me Nr.Prot.696/23 dhe 893/23 kundër vendimit të KShC-së Nr.Ref:533/23, datë 19.04.2023.

Ankuesi në ankesë pretendon se nuk është zbatuar drejtë UA nr. 15/2018 për Akreditimin e IAL-ve në Republikën e Kosovës në rastin e nxjerrjes së vendimit nga ana e KShC-së andaj dhe me ankesë ka kontestuar vendimin Nr.Ref:533/23, datë 19.04.2023, përkatësisht paragrafin II të dispozitivit të vendimit.

Komisioni i Ankesave ka pranuar raportin përmbledhës Nr.Ref:943/23 datë 17.07.2023, lidhur me ankesën Nr.Prot.696/23 dhe 893/23 të cilin raport së bashku me ankesën pa humbur kohë e ka shqyrtuar, ku dhe ka konstatuar se KShC në vendimin Nr.Ref:533/23, datë 19.04.2023 nuk ka zbatuar drejtë Udhëzimit Administrativ (MASHTI) Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, përkatësisht paragrafin 8, të nenit 18.

Komisioni ka konstatuar se sipas UA, në nenin 18, paragrafi 8, thuhet, citojmë "AKA do të publikojë në uebfaqen e saj vendimet për riakreditim si dhe raportin e vlerësimit të vlerësuesve të jashtëm për çdo institucion të arsimit të lartë dhe program studimi.", dhe sipas këtij paragrafi Kolegji Dardania nuk kishte

vendim për Riakreditim, por kishte vendim për aprovimin e tërheqjes nga procesi i akreditimit, e cila e drejtë ishte mundësuar me këtë UA.

Prë Komisioni konstaton se meqenëse vendimi Nr.Ref:533/23, datë 19.04.2023 ishte më shumë procedural dhe statusor e nuk ishte meritore që do të vendosej për akreditim apo mos akreditim, KShC nuk do të duhej të aplikonte paragrafin II të dispozitivit të vendimit.

Komisioni i ankesave i AKA-së gjatë shqyrtimit të ankesës ka administruar provat:

- Ankesën Nr.Prot.696/23 dhe parashtrësën Nr.prot.893/23;
- Vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC), Nr.Ref:533/23, datë 19.04.2023;
- Raporti përmbledhës i KShC-së për ankesën Nr.Ref:943/23 datë 17.07.2023;

Komisioni Ankesave i AKA, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, provave materiale, seancës dëgjimore si dhe analizimit të të gjitha pretendimeve të palës ankuese, ka konstatuar se pretendimi ankimore i parashtruesit të ankesës që ka të bëjë me paragrafin II të dispozitivit të vendimit Nr.Ref:533/23, datë 19.04.2023 qëndron, dhe se KShC-së në mënyrë jo të drejtë ka aplikuar dispozitën e nenit 18, përkatësisht paragrafin 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

Vendimi i Komisionit të Ankesave brenda afateve ligjore i është dërguar KShC-së e cila në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më 25 gusht 2023 ka shqyrtuar propozimin e Komisionit të Ankesave dhe ka vërtetuar se arsyetimi i Komisionit të Ankesave qëndron dhe rrjedhimisht aprovohet vendimi i KA.nr.1062/23 i datës 04.08.2023.

Bazuar në faktet e prezantuara dhe kompetencat ligjore KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar.*

Vendimi ju dërgohet :

- Kolegjit Dardania në Prishtinë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Assoc. Dr. Maja Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë